

## STATUT I

### SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR " REJAN CO" SHPK

#### KREU I

##### EMRI I SHOQERISE, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI

###### Neni 1 – Emertimi dhe forma Ligjore e Shoqerise

- 1.1 Emri I shoqerise me pergjegjesi te kufizuar eshte "REJAN CO" Sh.p.k. (ne vijim "Shoqeria").
- 1.2 Shoqeria REJAN CO Sh.p.k. themelohet ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne formen e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar dhe rregullohet prej ketij statuti dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.
- 1.3 Emri i shoqerise mund te ndryshohet me vendim te Asamblese se Ortakeve.
- 1.4 Shoqeria ka vulen dhe logon e saj zyrtare.

###### Neni 2 - Selia

- 2.1 Selia e Shoqerise eshte ne adresen: Yzberisht,Rruga 3 Deshmoret,Zona Kadastrale Nr.3866,Numer Pasurie 368/34-N2.Kati 1,Nr 1., Tirane, Shqiperi.
- 2.2 Asambleja e Pergjithshme mund te hapi, transferoje dhe/apo mbylle, si ne Shqiperi ashtu edhe jashte saj, dege dhe/ose zyra perfaqesimi. Ndersa, Administratori i Shoqerise mund te hapi, transferoje dhe/apo mbylle, si ne Shqiperi ashtu edhe jashte saj, seli sekondare dhe/ose filiale.

###### Neni 3 – Kohezgjatja

- 3.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore me afat te pacaktuar.
- 3.2 Shoqeria mund te priset ne cdo moment me vendim te Asamblese se Pergjithshme.

###### Neni 4 – Objekti i Shoqerise

4.1 Import, eksport, tregetim, shfrytezimin e gureve gelqeror, gurore, karierave te zhavorit dhe minierave, asfaltim rruges, autobetoniere, pompa betoni, çekiçe shkaterrues, transport etj. Transport inertesh për të tretet. Import eksport mjete transporti, eskavatore, etj. Zbatim i punimeve te ndertimit, punim dheu, murature, betonarme, shembje, sistemime etj. Shitje kamionash dhe automjete. Ndertim rruge, vepra arti, kanalizime, ndertim gazsjellesa, godina civile etj. Punime ne sipërfaqe te gjelberta, prodhim materiale inerte, ndertime detare, punime thellimi ne porte.Punime te montimit ne impjantet e prodhimit dhe shperndarjes se energjise, linja te TL dhe TU e te mesem, aparatura teknike dhe mirembajtja e tyre. Prodhime druri, metalike. Tregti me pakice te pjeseve te kembimit per makineri e pajisje, sherbime ne montim dhe çmontim te pajisjeve dhe makineri industriale, vajra, graso. Transport rrugor te inerteve te ndertimit si dhe te mallrave te ndryshme per te trete brenda dhe jashte vendit. Pike grumbullimi per tregti, ambalazhim dhe eksport te produkteve bujqesore ( fruta - perime ) . Shitje me shumice dhe pakicë të mallrave te ndryshem shtepika, lodra per femije, aksesor kuzhine, kopshtarie, higjenik, kozmetik, tekstile etj. Import dhe eksport perpunim, paketim dhe shitje me shumice dhe pakice vajrash lubrifikante, aditiv, antrifiz, pjese kembimi, goma, bateri, materiale elektrike, si dhe kimikate te te gjitha llojeve, aksesore etj.

4.2 Celja dhe administrimi i pikave te tregtimit me pakice te produkteve tekstile, veshjeve dhe aksesoreve te te gjitha llojeve nen franchising apo nen marken/at e saj;

4.3 Shitja me shumice e pakice e mallrave industriale dhe jo ushqimore;

4.4 Shitja, blerja dhenia me qira e pasurive te paluajtshme, transport i mallrave dhe udhetareve brenda dhe jashte vendit.

4.5 Shoqeria mund te kryeje cdo lloj veprimtarie apo transakcioni tjeter qe lidhet me pasuri te luajtshme e te paluajtshme, me kryerjen e veprimeve tregtare, industriale, bankare dhe/ose financiare te cfaredo lloji dhe natyre, te nevojshme ose te dobishme per arritjen dhe ose plotesimin e objektivit te Shoqerise, qe nuk ndryshon aktivitetin paresor te Shoqerise dhe nuk bie ne kundërshtim me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e importit/eksportit, tregtimit me shumice dhe/ose pakice te naftes, gazit, nenprodukteve perfshire ato bio si dhe lendet djegese, menaxhimi pikave te karburantit si dhe cdo aktivitet tjeter ndihmes i aktiviteteve te mesiperm. Shoqeria mund te themeloje, zoteroje pjesemarrje, te kontrolloje shoqeri te tjera tregtare, apo te bashkepunoje, te lidhe marreveshje te ngjashme, me shoqeri te tjera qe kane objekt te njejte apo te ngjashem me objektin e Shoqerise.

## **KREU II**

### **KAPITALI, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE TE SHOQERISE**

#### **Neni 5 – Kapitali I Shoqerise, kontributet dhe kuotat**

"REJAN CO" SHPK ("Shoqeria") eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 ( njeqind) leke, i ndare ne 1 ( kuota) me vlere minimale 100 ( njeqind) leke/ kuota te cilat zoterohen nga ortakut i saj si ne vijim:

Z. Martin Cobo, shtetas shqiptar, lindur ne Fier dhe banues ne Tirane, me 28.04.1980, me nr. personal I00428164M ortak zoterues I nje kuote qe perfaqeson 100% te kapitalit te shoqerise

#### **Neni 6 – Zmadhimi dhe Zvogelimi I kapitalit te Shoqerise**

6.1 Rritja e kapitalit mund te kryhet me vendim te Asamblese, kurdo dhe per me shume se nje here, permes kontributit ne para apo ne natyre apo me kredi, ne zbatim te dispozitave ligjore.

6.2 Rritja e kapitalit konsiderohet e kryher ne momentin kur kuotat e emetuara dhe te nenshkruara me pare jane shlyer teresisht.

6.3 Zvogelimi i kapitalit te Shoqerise mund te kryhet me vendim te Asamblese, ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi. Ne cdo rast kapitali i Shoqerise nuk mund te zvogelohet nen minimumin e parashikuar me ligj.

6.4 Zvogelimi i kapitalit mbartet prej secilit ortak proporcionalisht me kuotat qe ai ka ne kapitalin e Shoqerise.

#### **Neni 7– Transferimi i kuotave te shoqerise**

7.1 E drejta e pronesise mbi kuotat eshte lirisht e transferueshme tek te tretet ne perputhje me dispozitat e Ligjit nr.9901, date 14.03.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", I ndryshuar.

7.2 Ndalohet krijimi i te drejtave reale mbi kuotat e Shoqerise me qellim garantimin e detyrimeve te nje pale te trete, me ose pa pagese, pervecse kur me vendim te Asamblese se Pergjithshme parashikohet ndryshe

### **KREU III**

#### **ADMINISTRIMI**

##### **NENI 8 – Administrimi I Shoqerise**

Organi me i larte vendimarrës i Shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve. Vendimet kryesore te veprimtarise se Shoqerise merren me vendim te Asambleja e Ortakeve, e cila ka te drejten te miratoje vendime ne lidhje me te gjitha ceshtjet e aktivitetit te saj.

Konkretisht Asambleja, ka kompetenca per te vendosur per ceshtjet e meposhtme:

- a. ndryshimin e Statutit;
- b. rritjen dhe zvogelimin e kapitalit te shoqerise;
- c. pranimin e ortakeve te rinj dhe tansferimin e kuotave;
- d. bashkimin, ndarjen, transferimin, riorganizimin, shperberjen dhe cdo transferim tjetër te Shoqerise;
- e. blerjen, shitjen ose dhenien me qira te pasurive te paluajtshme te Shoqerise;
- f. emerimin dhe shkarkimin e Administratorit/eve,;
- g. miratimin e raporteve vjetore;
- h. miratimin e bilancit
- i. shperndarjen e fitimeve
- j. kerkon dhenien e kredive, hipotekave dhe/ ose dhenia e garancive.
- k. per te gjitha ceshtjet e tjera te cilat nuk parashikohen shprehimisht ne kete statut dhe qe I takojne ortakeve sipas ligjit per shoqerit tregetare.

Vendimet e Asamblese merren ne baze te kerkesave te kourumit dhe shumices perkatese te parashikuara nga ligji per shoqerist tregetare.

##### **NENI 9 – Administratori**

9.1 Administrimi i Shoqerise i caktohet nje administratori, per nje periudhe 5 ( pese) vjecare, me te drejte rizgjedhje. Ortaket kane te drejte te emerojne, apo shkarkojne ne cdo kohe administratorin.

9.2 Si Administrator I shoqerise emerohet:

Z. Martin Cobo, shtetas shqiptar, lindur ne Fier dhe banues ne Tirane, me 28.04.1980, me nr. personal 100428164M, shtetas Shqiptar, madhor e me zotesi te plote per te vepruar.

##### **NENI 10 - Te drejtat e Administratorit**

Administratori ushtron individualisht te drejtat e plota te caktuara per administrimin e Shoqerise dhe ka te drejten te miratoje vendimet qe gjykohen te drejta per arritjen dhe realizimin e objektit te Shoqerise, me perjashtimin e veprimeve qe me kete statut apo me ligj I jane rezervuar ortakeve.

Veprimet e meposhteme perfshihen ne aktet e administrimit te zakonshem:

- a. perfaqesimin e Shoqerise kundrejt paleve te treta dhe organeve publike;
- b. hapjen e llogarive bankare te Shoqerise prane Institucioneve bankare
- c. perfundimi i kontratave ose marreveshjeve me palet e treta;
- d. nenshkrimin e te gjitha dokumentave, leshimin e faturave, transferimet, pagesen e detyrimeve te Shoqerise;
- e. punesimi, shkarkimi, percaktimi i pagave dhe shperblimeve te tjera dhe cdo vendim tjetër lidhur me stafin e Shoqerise, ne perpudhje me udhezimet e miratuara nga Ortaket;
- f. mbajtja e librave kontabel, sic parashikohet nga ligji dhe parimet e kontabilitetit.
- g. pergatitja e pasqyrave financiare te Shoqerise dhe verifikimi i tyre nga auditore te jashtem, ne rast se kerkohet me ligj ose nga Ortaket;
- h. cdo veprim tjetër qe sipas ligjit per Shoqerite tregtare i takon administratorit te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar.

Administratori, me prokure te posacme mund t'i delegoje paleve te treta permbushjen e akteve te vetme ose kategori te akteve.

#### **KREU IV**

##### **VITI FINANCIAR, PASQYRAT FINANCIARE VJETORE, NDARJA E FITIMIT**

###### **NENI 11 – Viti financiar dhe bilanci vjetor**

11.1 Viti ushtrimor fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor.

11.2 Viti i pare ushtrimor fillon ne daten e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit, dhe perfundon me 31 Dhjetor, te te njejtit vit.

11.3 Pasqyrat financiare dhe raporti i ecurise i hartuar prej Administratorit miratohen prej Asamblese se Pergjithshme.

11.4 Miratimi i dokumenteve lidhur me vitin ushtrimor duhet te kryhet brenda 6 (gjashte) muajve nga perfundimi i vitit financiar

###### **NENI 12 – Fitimet**

12.1 Fitimet neto qe rezultojne nga pasqyrat financiare vjetore, pasi jane zbritur te gjitha shumet qe Asambleja e Pergjithshme ka vendosur te vere menjane, i shpemdahen ortakeve te shoqerise.

12.2 Asambleja, gjithashtu, mund te vendose te mbaje shuma te caktuara si rezerva, apo te shtyje shpemdardjen e fitimeve - teresisht apo pjeserisht — ne vitet ushtrimore pasardhes.

#### **KREU V**

##### **SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE**

###### **NENI 13 – Shperndarja**

13.1 Shoqeria shperndahet ne perfundim te afatit te saj parashikuar ne statut apo edhe perpara ketij afati, ne rastet e parashikuar nga ligji apo me vendim te Asamblese se Pergjithshme, me shumicen e parashikuar per modifikimin e Statutit te Shoqerise.

#### NENI 14 – Likuidimi

14.1 Ne rast shperndarje Shoqeria do te kaloje ne likuidim

14.2 Per te administruar kete procedure, Asambleja e Pergjithshme do te emeruje nje apo me shume likuidatore, te cilet do te paraqesin raportin perfundimtar mbi gjendjen e pasivit dhe aktivitet te Shoqerise, mbi veprimet e likuidimit dhe kohen e nevojshme per te perfunduar likuidimin.

14.3 Ne perfundim te procedures se likuidimit, Asambleja e Pergjithshme do te marre vendim ne lidhje me bilancin financiar perfundimtar, mbi vlefshmerine e punes se kryer prej likuidatorit dhe mbi perfundimin e procedures se likuidimit. Pas shlyerjes se kreditorëve, likuidatori shperndan te ardhurat perfundimtare te likuidimit tek ortakët, ne propocion me kuotat qe zoterojne.

### KREU V

#### DISPOZITAT E FUNDIT

#### NENI 15 – Zgjidhja e mosmarreshjeve

15.1 Te gjitha mosmarreshjet qe lindin nga ose ne lidhje me interpretimin ose zbatimin e ketyre dispozitave Statutore, midis ortakëve ose midis nje ose me shume ortakëve dhe Shoqerise, do te zgjidhen me marreshje midis paleve te interesuara. Ne rast se nuk arrihet nje zgjidhje me marreshje, palet do te mund t'i drejtohen Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

#### NENI 16 – Dispozitat ligjore ne fuqi

16.1 Per gjithcka qe nuk parashikohet ne kete Statut, zbatohen dispozitat ligjore ne fuqi.

#### NENI 17 – Gjuha

17.1 Ky statut hartohet ne 4 ( kater) kopje ne gjuhen shqipe.

Tirane, me 12 qershor 2023

ORTAKET E SHOQERISE

**Martin COBO**



